

## SYLLABUS i lëndës: Praktika Pedagogjike IV (10 javë)

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	<b>Fakulteti i Edukimit/ Programi: BA Fillor</b>
Titulli i lëndës:	<b>Praktika Pedagogjike IV (10javë)</b>
Niveli:	<b>Bachelor</b>
Statusi lëndës:	<b>I obliguar</b>
Viti i studimeve:	<b>VIII (i tretë), sem. i tetë</b>
Numri i orëve në javë:	<b>3+0</b>
Vlera në kredi – ECTS:	<b>6</b>
Koha / lokacioni:	<b>E hënë gr.3 11:00 -13:15</b> <b>Salla: Praktika pedagogjike</b>
Mësimdhënësi i lëndës:	<b>Jehona Ferizi Miftari</b>
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:jehona.ferizi-miftari@uni-pr.edu">jehona.ferizi-miftari@uni-pr.edu</a> Fakulteti i Edukimit, K i IV <sup>të</sup> , zyra nr. 16
Përshkrimi i lëndës	
	<b>Praktika Pedagogjike IV</b> u mundëson studentëve të vitit të katërt të zbatojnë njohuritë teorike në një mjedis të vërtetë shkollor, duke iu ndihmuar të zhvillojnë aftësi të avancuara në planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies. Kjo praktikë fokusohet në përshtatjen me ndryshimet e kurrikulës, zbatimin e metodologjive bashkëkohore të bazuara në kompetenca dhe të nxënit e integruar. Studentët do të angazhohen në planifikimin e aktiviteteve që stimulojnë të menduarit kritik dhe kreativ, menaxhimin e klasës, mbështetjen e nxënësve me nevoja të ndryshme dhe identifikimin e sjelljeve problematike. Gjithashtu, do të theksohet rëndësia e bashkëpunimit me kolegët, stafin e shkollës dhe prindërit. Nëpërmjet reflektimit mbi përvojën e tyre dhe zhvillimit të praktikave të bazuara në hulumtim, studentët do të aftësohen për një qasje profesionale dhe fleksibile ndaj mësimdhënies, duke u përgatitur për sfidat dhe dinamikat e profesionit të tyre si mësimdhënës.
Qëllimi i lëndës	
	<b>Qëllimi i Praktikës Pedagogjike IV</b> është të përgatisë studentët e vitit të katërt për të zbatuar në mënyrë efektive njohuritë teorike në një mjedis real mësimor. Kjo praktikë synon t'i ndihmojë ata të zhvillojnë aftësi profesionale në planifikimin dhe zbatimin e mësimdhënies, të përshtaten me ndryshimet e kurrikulës dhe të zbatojnë metodologji bashkëkohore të bazuara në kompetenca. Përmes përvojës së drejtpërdrejtë në shkolla, studentët do të mësojnë të menaxhojnë klasën, të identifikojnë dhe të mbështesin nevojat e ndryshme të nxënësve, të bashkëpunojnë me kolegët dhe

	prindërit, si dhe të zhvillojnë reflektimin kritik mbi praktikën e tyre. Në këtë mënyrë, ata do të aftësohen si mësimdhënës të ndërgjegjshëm, fleksibël dhe inovativë, të gatshëm për t'u përballur me sfidat e profesionit.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>			
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	15 javë	45
Punë praktike dhe ushtrime në teren	7	10 javë	70
Kontaktet mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Projektet,prezntimet ,etj	1	3	3
<b>Totali: 205/28 ~ 6 ECTS</b>			205 orë totale
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Metodologjia e mësimdhënies për studentët përqendrohet në zhvillimin e aftësive kritike dhe analitike përmes përdorimit të metodave të orientuara nga studenti. Aktivitetet mësimore janë të strukturuar për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të studentëve, duke u angazhuar ata në diskutime, projekte kërkimore dhe analiza të rasteve reale. Përdorimi i metodave të mësimdhënies të diferencuara siguron përshtatjen me nivelet dhe nevojat e ndryshme të studentëve, ndërkohë që teknologjia dhe burimet digjitale pasurojnë mësimin dhe krijojnë mundësi për mësim aktiv dhe interaktiv. Vlerësimi i vazhdueshëm dhe i bazuar në kompetenca ndihmon studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe intelektuale, duke u mundësuar atyre të zbatojnë teorinë në situata praktike. Kjo		

	<p>metodologji promovon reflektimin mbi procesin mësimor, duke u mundësuar studentëve të zhvillojnë një qasje të pavarur dhe të qëndrueshme ndaj të mësuarit dhe të përgatiten për sfidat profesionale.</p> <p><b>Të gjitha materialet e kursit do të publikohen në platformën <a href="https://sems.uni-pr.edu/">https://sems.uni-pr.edu/</a></b></p>
<p><b>Metodat e vlerësimit:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Pjesëmarrja dhe angazhimi në klasë – 10%</b> Aktiviteti në diskutime dhe ushtrime praktike.</li> <li>• <b>Planifikimi dhe dokumentimi i procesit mësimor –30 %</b> Përgatitja dhe dorëzimi i planifikimeve ditore, javore. Reflektimi në ditarin e studentit mbi përvojat e mësimdhënies. Dokumentimi i së paku 3 vëzhgimeve të nxënësve përmes instrumenteve narrative dhe të strukturuar.</li> <li>• <b>Realizimi i orës mësimore në klasë – 30%</b> Organizimi dhe zbatimi i një ore të plotë mësimore përpara nxënësve. Përdorimi i metodave të përshtatshme mësimore sipas kurrikulës.</li> <li>• <b>Vlerësimi nga mentorët dhe profesorët – 20%</b> Vlerësimi nga profesori mbikëqyrës pas vëzhgimit të orës mësimore. Vlerësimi nga mësimdhënësi mentor në shkollë.</li> <li>• <b>Vetëvlerësimi dhe reflektimi – 10%</b> Vetëvlerësimi mbi performancën e realizuar. Reflektimi mbi mësimet e nxjerra nga përvoja mësimore dhe mënyrat për përmirësim të mëtejshëm.</li> </ul>
<p><b>Literatura</b></p>	
<p><b>Literatura bazë:</b></p> <p><b>Të gjitha materialet e kursit do të publikohen në platformën <a href="https://sems.uni-pr.edu/">https://sems.uni-pr.edu/</a></b></p>	<p><b>Literatuara e obliguar:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Fakulteti i Edukimit.</b> (2004) Doracaku për mësimin praktik.</li> <li>2. <b>MASHT (2017).</b> Korniza e Kurrikulës së Kosovës</li> <li>3. <b>MASHT ( 2017)</b> Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës ( klasa 0, I,II, III , IV dhe V)</li> <li>4. <b>USAID ( 2013)</b> Zhvillimi i Shkathësive të Shekullit 21 në klasat me NXËNËSIN NË QENDËR</li> </ol>

	<ol style="list-style-type: none"> <li>5. <b>Tomlinson, C. A. (2001).</b> <i>How to Differentiate Instruction in Mixed-Ability Classrooms.</i> ASCD.</li> <li>6. <b>Ahmedi, V. (2019).</b> Teachers' attitudes and practices towards formative assessment in primary schools. <i>Journal of Social Studies Education Research</i>, 10(3), 161–175.</li> <li>7. <b>Cooper, J. M. (2014).</b> <i>Classroom Teaching Skills.</i> Cengage Learning.</li> <li>8. <b>Brookfield, S. D. (2017).</b> <i>Becoming a Critically Reflective Teacher.</i> Jossey-Bass.</li> <li>9. Hoxha, Rr. (2023). Të nxënit përmes përvojës/ Metodologji praktike e mësimdhënies.</li> <li>10. Potter, M. (2015). 100 Ideas for Primary Teachers: Behaviour Management. Bloomsbury Publishing.</li> <li>11. UNESCO. (2006). Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse: Një udhëzues për mësues dhe trajnerë; UNESCO dhe Save the Children (2007); Programi për Shqipërinë (varianti shqip). <a href="https://resourcecentre.savethechildren.net/sites/default/files/documents/positive_discipline_in_the_inclusive_learning-friendly_classroom_albanian.pdf">https://resourcecentre.savethechildren.net/sites/default/files/documents/positive_discipline_in_the_inclusive_learning-friendly_classroom_albanian.pdf</a></li> <li>12. <a href="https://aktivitetet.toka-ks.org/">https://aktivitetet.toka-ks.org/</a></li> </ol>
<p><b>Literatura shtesë:</b></p>	<p><b>B) Literatura shtesë</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Grup autorësh (2005).</b> Mësimdhënia me në qendër nxënësi, Tiranë</li> <li>2. <b>Grup autorësh (2010).</b> Mësimdhënia dhe të nxënit (kl. 1-5), Tiranë</li> <li>3. <b>Bardhyl Musai (2012).</b> Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë,</li> <li>4. <b>Anderson, L. W., &amp; Krathwohl, D. R. (2001).</b> <i>A Taxonomy for Learning, Teaching, and Assessing: A Revision of Bloom's Taxonomy of Educational Objectives.</i> Longman.</li> <li>5. <a href="http://shqip.phzh.ch">Shqip (phzh.ch)</a></li> </ol>

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i><b>Java e parë:</b></i>	Përshkrimi i kursit, detyrat dhe përgjegjësit
<i><b>Java e dytë:</b></i>	Përshtatja me ndryshimet e kurrikulës dhe ndikimi i tyre në mësime - Rolet e shumëfishta të mësimit sot
<i><b>Java e tretë:</b></i>	Përdorimi i metodave bashkëkohore për zhvillimin e aftësive të nxënësve në planifikimin e mësimit
<i><b>Java e katërt:</b></i>	Zbatimi i mësimit të integruar dhe ndihma në zhvillimin e menduarit kritik dhe kreativ
<i><b>Java e pestë:</b></i>	Identifikimi i nevojave të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe mbështetje për zhvillimin e tyre
<i><b>Java e gjashtë:</b></i>	Rëndësia e bashkëpunimit me kolegët dhe staf të shkollës në procesin e mësimit
<i><b>Java e shtatë:</b></i>	Menaxhimi i sjelljeve problematike dhe promovimi i një mjedisi pozitiv për nxënësit
<i><b>Java e tetë:</b></i>	Menaxhimi i klasës: Strategji për të rritur disiplinën dhe përfshirjen e nxënësve
<i><b>Java e nëntë:</b></i>	Integrimi i metodave të vlerësimit të bazuara në kompetenca në procesin e mësimit
<i><b>Java e njëmbëdhjetë:</b></i>	Reflektimi mbi praktikën e mësimit: Përdorimi i hulumtimit për zhvillimin profesional

<b><i>Java e njëmbëdhjetë:</i></b>	Rëndësia e angazhimit të prindërve në zhvillimin e aftësive të nxënësve
<b><i>Java e dymbëdhjetë:</i></b>	Përdorimi i teknologjisë në mbështetje të mësimdhënies bashkëkohore dhe të integruar
<b><i>Java e trembëdhjetë:</i></b>	Strategjitë për zhvillimin e aftësive të menduarit kritik tek nxënësit gjatë mësimit
<b><i>Java e katërbëdhjetë</i></b>	Përshtatja e aktiviteteve të mësimdhënies për nxënësit me nevoja të ndryshme dhe përfshirja e tyre
<b><i>Java e pesëmbëdhjetë</i></b>	Zhvillimi i një qasjeje fleksibile ndaj mësimdhënies për të adresuar sfidat në klasë
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Secili student ka të drejtë të bëjë pyetje e komente sa herë që i jepet fjala;</li> <li>- Studentët priten të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aktivitetet në klasë dhe të vijnë në klasë të përgatitur për të diskutuar materialin e caktuar</li> <li>- Asnjëri nuk ka të drejtë t’i ndërhyjë tjetrit kur ai e ka fjalën;</li> <li>- Lejohet “zhurma” e punës kur studentët punojnë në grupe;</li> <li>- Nuk lejohet prishja e qetësisë kur ligjërohet nga mësimdhënësi apo prezentohet puna e studentëve;</li> <li>- Të gjithë telefonat celularë duhet të jenë në heshtje gjatë gjithë orës së mësimit.</li> <li>- Nuk lejohet ardhja me vonesë apo dalja pa ndonjë arsye të qëndrueshme;</li> <li>- Dënohet cdo formë e kopjimit apo falsifikimit.</li> </ul> <p>➤ <i>Kursi do të jetë vështirë të përfundohet me sukese, nëse keni mungesa.</i></p> <p>➤ <i>Në vlerësimin përfundimtar kanë të drejtë të paraqiten vetëm studentët që kanë marrë pjesë në ligjëratat dhe të cilët kanë përfunduar me sukses mësimin praktik në shkollë.</i></p>	